



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 637, datë 19.10.2023

PËR

**NJË NDRYSHIM NË LISTËN E GJYQTARËVE UDHËHEQËS TË CAKTUAR ME
VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NR. 466, DATË 25.07.2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61 dhe 97, pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 14 dhe 33 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023 gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023-2024, duke zëvendësuar gjyqtarët udhëheqës:
 - a) z. {...} me gjyqtarët:
 - i) z. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024) dhe;
 - ii) z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat z. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024);
 - b) znj. {...} me gjyqtarët:
 - i) znj. {...}, në cilësinë e gjyqtares udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024);
 - ii) z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat z. {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024);
 - iii) z. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat z. {...} për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024) dhe;
 - iv) z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024).

- c) Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjyqtarëve z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe z{...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË
PROFESIONALE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

RELACION

PËR

**PROJEKTVENDIMIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LISTËN E GJYQTARËVE
UDHËHEQËS TË CAKTUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR NR. 466, DATË 25.07.2023”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton gjykatat e shkallës së parë pranë të cilave kandidatët për gjyqtarë, në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës, do të kryejnë praktikën profesionale. Me vendimin nr. 316, datë 22.07.2021 Këshilli ka proceduar me caktimin e trupës së gjyqtarëve udhëheqës, për një periudhë 3-vjeçare, përkatësisht për vitet 2021-2024, trupë e cila është përditësuar me vendimet nr. 242, datë 30.06.2022 dhe nr.356, datë 06.07.2023.

Me vendimin nr. 466, datë 25.07.2023 Këshilli ka caktuar gjykatat dhe gjyqtarët udhëheqës gjatë praktikës profesionale për kandidatët për magistratë, për vitin akademik 2023-2024, sipas listës bashkëlidhur vendimit, për katër mujorin e parë (korrik – tetor 2023), të dytë (nëntor 2023-shkurt 2024) dhe të tretë (mars 2024-qershor 2024). Ky vendim është ndryshuar pjesërisht me vendimin nr.470, datë 26.07.2023, duke caktuar për kandidaten për magistratë znj. {...}, si gjyqtar udhëheqës znj. {...} në sesionin e parë katër mujor korrik 2023 – tetor 2023 dhe znj. {...} në sesionin e dytë katër mujor nëntor 2023- shkurt 2024 (*për shkak të kërkesës të kandidates për magistratë për arsye familjare*); me vendimin nr. 482, datë 13.09.2023, duke zëvendësuar gjyqtarin udhëheqës z. {...} (*për shkak të mbarimit të statusit*) me gjyqtarët udhëheqës {...} në sesionin e parë 4-mujor (korrik – tetor 2023), {...} në sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024) dhe znj. {...} në sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024).

Rezulton se dy nga gjyqtarët udhëheqës të caktuar për kandidatët për magistratë gjatë këtij vitit akademik janë gjyqtarët {...} dhe {...}, gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të cilët me vendimet nr.539, datë 12.10.2023 dhe nr.540, datë 12.10.2023 janë caktuar për të gjykuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit për një periudhën 3/vjeçare.

Referuar parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është Këshilli i Lartë Gjyqësor që jo vetëm përcakton trupën e magistratëve gjyqtarë udhëheqës për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët për magistratë, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara me ligj, por edhe përditëson trupën e miratuar, në rastet kur magistratët e miratuar, gjenden në pamundësi për të përmbushur këtë funksion. Në rastin konkret, në kushtet kur gjyqtarët {...} dhe {...} nuk e ushtrojnë detyrën në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë pasi janë caktuar në skemë delegimi për të gjykuar në Gjykatën Administrative të Apelit, është e nevojshme të bëhet zëvendësimi i tyre me gjyqtar të tjetër, të cilët janë pjesë e listës së miratuar me vendimin nr. 316, datë 22.07.2021, përditësuar me vendimet nr. 242, datë 30.06.2022 dhe nr.356, datë 06.07.2023, si dhe ushtron funksionin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Referuar listës së miratuar të gjyqtarëve udhëheqës për vitin akademik 2023-2024 të cilët ushtrojnë detyrën pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se gjashtë janë të angazhuar duke u caktuar pranë tyre nga dy kandidatë për magistratë, për shkak se për vitin akademik 2023-2024 numri i kandidatëve është më i lartë se numri i gjyqtarëve udhëheqës që ushtrojnë funksionin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.¹

Në këto kushte, zëvendësimi i gjyqtarëve udhëheqës {...} dhe {...} në sesionin e dytë dhe tretë të 4-mujorit të praktikës profesionale dikton nevojën e angazhimit të gjyqtarëve me caktimin pranë tyre të 2 kandidatëve, në të dy sesionet në të cilat do të kryhet zëvendësimi. Në caktimin e gjyqtarëve pranë të cilëve do të kryejnë stazhin profesional kandidatët e caktuar më herët pranë gjyqtarëve {...} dhe {...} , KVEVP propozon zëvendësimin me gjyqtarët {...}, duke konsideruar se faktin se (i) gjyqtarët janë pjesë e trupës së magistratëve udhëheqës të miratuar me vendimin nr. 316, datë 22.07.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të përditësuar me vendimet nr.242, datë 30.06.2022 dhe nr.356, datë 06.07.2023 (ii) ushtrojnë funksionin pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe (iii) rezultojnë të jenë caktuar gjyqtarë udhëheqës për të tre sesionet 4-mujore të vitit akademik 2022-2023, duke u caktuar pranë tyre, në sesionin respektiv, vetëm nga një kandidat për magistrat.

Për këto arsye, KVEVP vlerëson se ka vend për zëvendësimin e gjyqtarëve udhëheqës:

- (i) z. {...} me gjyqtarin z. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatës për magistratë znj. {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024) dhe me gjyqtarin z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magistrat z. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024);

¹ Nëpërmjet vendimit nr. 466, datë 25.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të ndryshuar me vendimet nr.470, datë 26.07.2023 dhe nr.482, datë 13.09.2023 për shkak se numri i kandidatëve për magistratë në të tre sesionet e praktikës profesionale, është më i lartë se numri i gjyqtarëve udhëheqës, janë caktuar në 6 raste nga 2 magistratë pranë të njëjtit gjyqtar. Konkretisht, në sesionin e parë 4/mujor janë caktuar dy kandidatë pranë gjyqtarëve Gentian Hamiti, Bezart Kaçkini dhe Avni Sejdi, në sesionin e dytë pranë gjyqtarëve Bezart Kaçkini, Etleva Gjamo dhe Nafije Hasko dhe në sesionin e tretë pranë gjyqtarëve Nafije Hasko dhe Selviqe Gjocaj.

- (ii) znj. {...}me gjyqtaren znj. {...}, në cilësinë e gjyqtarës udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...} dhe me gjyqtarin z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magjistrat z. {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024); me gjyqtarin z. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magjistrat z. {...}dhe me gjyqtarin z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024).

Angazhimi i gjyqtarëve si më sipër, në një ose dy sesione, duke caktuar pranë tyre nga 2 kandidatë për gjyqtarë, është i kushtëzuar nga fakti që në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën kryejnë praktikën profesionale 21 (njëzet e një) kandidatë për gjyqtarë, të ndarë në dy periudha 4-mujore, ushtrojnë detyrën 9 (nëntë) gjyqtarë² nga të cilët, pas caktimit në skemë delegimi të gjyqtarëve {...}dhe {...}, mbeten vetëm 7 (shtatë) prej tyre, të përfshirë në trupën e gjyqtarëve udhëheqës. Ndërkohë që numri i kandidatëve është 21 (njëzet e një) dhe të ndarë sipas periudhave rezulton se për dy sesionet duhet të atashohen pranë 7 (shtatë) gjyqtarëve, përkatësisht 11 dhe 10 kandidatë.

Për sa më sipër, ***në pikën 1 të projektvendimit***, është parashikuar ndryshimi pjesërisht i vendimit nr.466, datë 25.05.2023, “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023-2024”, duke zëvendësuar gjyqtarët udhëheqës (i) z. {...} me gjyqtarin z. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024) dhe me gjyqtarin z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magjistrat z. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024) dhe (ii) gjyqtaren udhëheqëse znj. {...} me gjyqtaren znj. {...}, në cilësinë e gjyqtarës udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...} dhe me gjyqtarin z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magjistrat z. {...}, për sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024); me gjyqtarin z. {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidatit për magjistrat z. {...} dhe me gjyqtarin z. {...} në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magjistrate znj. {...}, për sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024).

Në pikën 2 të projektvendimit parashikohet njoftimi i tij Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe gjyqtarëve z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Së fundmi, parashikohet momenti i hyrjes në fuqi menjëherë dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, referuar parashikimeve të nenit 98, pika 3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

² Gjyqtari Ramiz Lala i caktuar në trupën e gjyqtarëve udhëheqës, me vendimin e përditësuar nr.356, datë 06.07.2023 aktualisht ushtron detyrën në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shkak të transferimit të përkohshëm me vendimin nr.530, datë 11.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor

**KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË
PROFESIONALE
RELATORE**